



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 8
Prishtinë, më 27.02.2015, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-II

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS

Në mbledhje morën pjesë: Daut Haradinaj- kryetar, Rexhep Selimi, Ganimete Musliu, Anton Quni, Nuredin Ibishi, Zafir Berisha dhe Qerim Bajrami-anëtarë.

Munguan: Fadil Demaku dhe Bojan Mitiq

Përfaqësuesit nga Ministria e FSK-së: Ministri i FSK-së, z. Haki Demolli, Komandanti i FSK-së, Gjenerallejtënant, Kadri Kastrati, Sekretari i përgjithshëm i MFSK-së, Shkelzen Sylaj, Dominic Braithwaite- Udhëheqës i ekipit këshillues të NATO-s në MFSK.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Ardiana Gashi- OSBE; Lumnije Murati- Zyra e Presidentes së Kosovës; Krenare Loxhaj- QKSS, Luanda Domi- DCAF dhe Arbana Pireva- Praktikante.

Nga Staf i Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku dhe Zarife Aliu.

Mbledhjen e kryesoi, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit të mbajtur më 18.02.2015;
3. Raportimi i ministrit të FSK-së z. Haki Demolli, Komandatit, Gjenerallejtënant Kadri Kastrati dhe Sekretarit të Ministrisë, z. Shkelzen Syla;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit të mbajtur më 18.02.2015

Procesverbali i mbledhjes së Komisionit të mbajtur më 18.02.2015 u miratua pa vërejtje.

3. Raportimi i ministrit të FSK-së z. Haki Demolli, Komandatit, Gjenerallejtënant Kadri Kastrati dhe Sekretarit të Ministrisë, z. Shkelzen Syla

Kryetari- Në fillim të takimit njoftoi se për raportim në Komision janë ftuar ministri, Komandanti dhe Sekretari i FSK-së. Gjithashtu theksoi se raportin vjetor nga Komandanti i FSK-së e kemi pranuar dhe i njëjti i është shpërndarë anëtarëve. Më tutje fjalën ia dha ministrit, z. Haki Demolli.

Ministri Ministrisë së FSK-së- Haki Demolli- Fillimisht dorëzoi te kryetari raportin vjetor të gjithë anëtarëve të Komisionit. Në fillim të javës së tij theksoi se sa i përket transformimit të FSK-së në FAK shtoi se Ministria e FSK-së ka qenë bartëse e procesit të rishikimit strategjik të sektorit të sigurisë, dhe se gjatë periudhës 2013-2014 janë nxjerrë disa rekomandime. Gjatë këtij procesi Ministria e FSK-së ka bashkëpunuar Defence Institut Review, ekip i specializuar nga SHBA- ja, si dhe me Gardën Kombëtare të Ajovas dhe se gjatë këtij procesi ka ardhur deri te draftimi i projektligjit për transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës.

Gjithashtu në seancën e fundit të Kuvendit pas pyetjeve nga ana e deputetëve kam informuar se nga ana e Ministrisë ka përfunduar draftimi i projektligjit për këtë transformim dhe ky projektligj është përcjellë në Ministrinë e Financave dhe në Ministrinë e Integritetit Evropian, të cilat kanë dhënë deklaratat lidhur me këtë projektligj.

Gjithashtu kemi menduar që javën që vjen këtë projektligj ta procedojmë në Qeveri e më pas të procedohet në Kuvend. Po ashtu theksoi se para se të procedohet ky projektligj në Kuvend duhet të aprovohen amendamentet kushtetuese që kanë të bëjnë me transformimin e FSK-së në FAK. Tutje theksoi se Ministria e FSK-së ka ngritur Komisionin për implementimin e rekomandimeve që kanë dalë nga rishikimi i sektorit të sigurisë, ku krahas bazës ligjore është përgatitur plani i veprimit për implementimin e rekomandimeve, gjithashtu është duke u punuar të dizajnimin e strukturës së re të FSK-së dhe të Ministrisë.

Gjithashtu është duke u punuar në planin afatgjatë të zhvillimit të FSK-së, siç është draftimi i doktrinës së përgjithshme të FSK-së, si dhe draftimi i Librit të Bardhë, në të njëjtën kohë Ministria është duke u angazhuar në draftimin e strategjisë kombëtare dhe strategjisë së mbrojtjes.

Ndërsa sa i përket bashkëpunimit bilateral shtoi se Ministria ka nënshkruar njëmbëdhjetë memorandumi të bashkëpunimit, nëntë prej të cilave janë me shtete anëtare të NATO-s. Gjithashtu është nënshkruar programi për partneritetin shtetëror me Gardën Kombëtare të Ajovas, ndërsa me Shqipërinë është nënshkruar marrëveshja SOFA. Po ashtu theksoi se si Ministri e kanë edhe diplomacinë e mbrojtjes e cila është shpërndarë në disa vend të botës. Synimi është anëtarësimi në organizata të rëndësishme ndërkombëtare dhe në kuadër të kësaj Ministria e FSK-së ka arritur të jetë pjesë e Këshillit për Bashkëpunim Rajonal, si dhe në Qendrën Rajonale të Asistencës për verifikim dhe implementim të Armëve. Ndërsa në Kartën e Adriatikut Ministria e FSK-së është vetëm mysafire dhe synimi është që të bëhemi anëtare e plotë.

Për të qenë pjesë e NATO-s punojmë në këtë drejtim, por kemi parasysh që kjo është një sfidë pasi dihet që disa shtete anëtare të saj nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, por përkundër faktit që Ministria nuk ka raporte formale me NATO-n, e rëndësishme është që në kuadër të Ministrisë veprojnë dy ekipe këshilluese të NATO-s dhe se për vitin 2015 është hartuar plani i veprimit për pjesëmarrje në kurse të organizuara nga NATO, ku do të marrin pjesë nëntëmbëdhjetë pjesëtarë të FSK-së.

Kryetari- Falënderoi ministrin për këtë raportim, ndërsa në vazhdim bëri këtë pyetje. A ka pasur ndërhyrje në pakon ligjore për transformimin e FSK-së në FAK, e cila do të procedohet në Kuvend? Pasi siç dihet një pako e tillë është proceduar edhe në legjislaturën e kaluar. Ndërsa ai përket amendamentimit të Kushtetutës, çka nëse nuk mund të bëhet dakordimi me komunitetin serb?

Ministri i FSK-së-Haki Demolli- Theksoi se draft ligji për transformimin e FSK-së është hartuar, por krahas tij janë dërguar gjashtëmbëdhjetë amendamente kushtetuese në Gjykatë Kushtetuese të Kosovës dhe është e rëndësishme që sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese amendamentet nuk janë në kundërshtim me të drejtat e njeriut. Ndërsa sa i përket çështjes nëse do të votojë komuniteti serb, tha se kjo nuk është në kompetencë e tyre dhe se kjo i mbetet Kuvendit.

Gjenerallejtënant -Kadri Kastrati- Fillimisht njoftoi se për vitin 2014, Forca e Sigurisë së Kosovës bazuar në objektivat e përcaktuar ka punuar në ngritjen e kapaciteteve operationale duke bërë që FSK-ja të zhvillohet në drejtimin e duhur, ku rëndësi i është dhënë operationeve

brenda Republikës së Kosovës. Gjithashtu aspekt tjetër i rëndësishëm për FSK-në ka qenë edukimi dhe profesionalizmi përmes trajnimeve. Gjithashtu nga viti i kaluar i është kushtuar rëndësi edhe modernizimit dhe funksionalizimit të infrastrukturës, në pajisje dhe çështje të tjera. Vitin e kaluar ka filluar faza e trajnimit të një kontingjenti të ri për FSK-në ndërsa për këtë vit janë pranuar 150 pjesëtarë, ku janë të përfshirë shqiptarët, serbët dhe komunitetet e tjera.

Gjithashtu theksoi se operacion i suksesshëm nga ana e FSK-së për këtë vit ka qenë ai në Shqipëri, ku është ofruar ndihmë me rastin e shpërthimit të një dige të një liqeni, si dhe operacioni i gjetjes së një fëmije në lumë në Komunën e Lipjanit. Në përfundim të kësaj fjale theksoi se është i gatshëm t'u përgjigjet pyetjeve në vazhdim.

Anton Quni- Theksoi se faktori njeri në arritjen e sukseseve dhe objektivave është shumë i rëndësishëm. Lidhur me këtë bëri pyetjet si vijon: Si është raporti ndër njerëzor, respekti reciprok në hierarki dhe në zinxhirin komandues, si janë marrëdhëniet ndër njerëzore më konkretisht respekti reciprok në hierarki dhe zinxhirin komandues në lidhjen vertikale dhe horizontale? Si është bindja që zhvillimi në karrierë varet nga performanca e lartë dhe rezultatet në detyrë, disiplina, përmeshja e detyrave, kurse faktorët tjerë, siç është lojaliteti ndaj një partie politike janë të minimizuara? Në fund si është vlerësimi juaj, pjestarët e FSK-së, ushtarët, eprorët të rangut të mesëm, të rangut të lartë, a janë të motivuar nga shkaqet materiale t'i shërbejnë FSK-së apo është një motiv më i lartë siç është nderi për të shërbyer në uniformë?

Rexhep Selimi- Lidhur me raportin e komandantit të FSK-së, vlerësoi se raporti i Komandantit është një raport me strukturë dhe natyrë ushtarake, është i përpiluar mirë, por mendoj që çfarë do të prisnim në të ndryshonim në raportet periodike, vlerësoi që këto raporte janë shabllon. Raporti vjetor i këtij viti në krahasim me raportet e viteve të tjera nuk ndryshon shumë, sidomos sa i përket objektivave, të njëjtat tema kanë qenë edhe vitin e kaluar, si për shembull bërja e FSK-së forcë profesionale, bërja e FSK-së forcë kredibile, zakonisht stërvitja dhe aftësimi i FSK-së është permanente, por mendoj bërja e FSK-së forcë zbarkuese jashtë vendit, këtë e kemi bërë se është aprovuar një ligj në vitin e kaluar, bërja e FSK-së forcë për të mirë, ndosha nuk do të duhej për çdo vit të përdornim forcë për të mirë.

Më tutje shtroi disa çështje, për deri sa bëhet fjalë për ndryshimin e funksionit të FSK-së, ndryshim që bëhet me ndryshimin e Kushtetutës, ndryshimet kushtetues kanë sfidat e veta si u përmend votimi i dyfishtë, në Parlamentin e Kosovës. Kjo nuk na përket neve të diskutojmë në këtë rrafsh, por gjithsesi nuk jemi jashtë protagonizmit, sepse edhe ne jemi përfaqësues të subjekteve politike dhe mund të japim kontributet tona. Tutje shtroi pyetjet sa është punuar në doktrinën e ardhshme për Forcat e Armatosuar të Kosovës? Pasi vetëm ndryshimi nominal në Kushtetutë nuk është i mjaftueshëm, në mund të ndryshojmë neni e caktuar në Kushtetutë ku FSK-ja shëndërrohet në një Forcë Ushtarake për mbrojtjen e sovraniteti, integritetit territorial, qytetarët, pasurin dhe shtetin, por nuk besoj që ndryshimi nominal të jetë i mjaftueshëm, do të donim të dinim ne, si deputetë, sa është punuar në hartimin e doktrinës? Cilat janë ekipet që po e kryejnë këtë punë? Cilat janë ndryshimet sa i përket organizimit, strukturës dhe personelit që do të pësojë FSK-ja në momentin e shndërrimit në Forcë të Armatosuara të Kosovës për shkak se kjo është baza kryesore e ndryshimit sa i përket strukturës, organikes dhe personelit? Cilat do të jenë ndryshimet e Forcave të Armatosura krahas asaj që sot i ka FSK-ja? Gjithashtu theksoi që sot FSK-ja nuk i ka ato që ka të drejtë, nuk i ka ato që janë të lejueshme dhe nuk i ka arritur ato

kapacitete çfarë ka pasur mundësi t'i arrijë duke përfshirë edhe limitimet që ka pasur në ndërkohë, si nga Plani i Ahtisarit që kanë qenë limite pesëvjeçare.

A është i mjaftueshëm buxheti i paraparë nga Qeveria e Republikës së Kosovës i paraparë për FSK-në dhe Ministrinë e FSK-së, për shkak se jo pak deputetë kanë pasur vërejtje, në kuptimin pozitiv që ky buxhet është i pa mjaftueshëm për Forcën e Sigurisë së Kosovës? Çështje që do të duhej të rregulloni sidomos përdorimi i automjeteve taktike, automjetet taktike pasi përdoren jashtë misionit të tyre? Çështja tjetër është se edhe pse nuk kam shifra të sakta por mendoj që a do të jetë normale ku një pjesëtar i FSK-së të ketë njëkohësisht edhe shkallën e indivaliditetit 40%, ne e dimë që shkalla e indivalitetit të luftës 40% nuk i mjafton apo nuk i krijon komoditet të caktuar një pjesëtarit të caktuar ta kalojë testin fizik. Kështu që do të duhet ta rishikoni edhe njëherë për shkak se shkalla e individualitetit 40% për një oficer të Forcave të Sigurisë të Kosovës do ta bënte atë oficer të hiqte dorë nga përfitimet e indivalitetit të luftës ose detyra e ushtarakut, për shkak se këto të dyja nuk shkojnë bashkë.

Nuredin Ibishi- Lidhur me punën e Ministrisë së Forcës së Sigurisë, por edhe për Forcën e Sigurisë së Kosovës që pretendojnë këto nismat e reja për ndryshimet kushtetuese edhe të ligjeve dhe rreth çështjeve që na përkasin neve, rreth strategjisë së sigurisë së Kosovës e cila është një pjesë e jona. Tutje shtroi çështjen rreth një forme të sensibilizimit të të rinjve kur ka të bëjë me rekrutimin edhe për punësim si pjesë e Forcës së Sigurisë, sidomos trajnimeve të ndryshme.

Vlerësoi se nuk është mirë që të ketë nepotizëm dhe ju duhet të vazhdoni ta bëni konform dispozitave tuaja. Gjithashtu ka qenë edhe komenti se të rinjtë tanë nuk i plotësojnë standardet të akademisë ushtarake West Point, por mendoj që mungon një forme e sensibilizimit të të rinjve, një forme e propagandës dhe njoftimit me qëllim të rekrutimit të tyre.

Çështja tjetër, Kosova si një vend i vogël që pretendon integritet është mirë sidomos pasi është nënshkruar marrëveshja SOFA me Shqipërinë që të kemi akademi të përbashkëta ushtarake sidomos për nivelin e lartë.

Edhe ajo që e thashë më herët pasi që veç u parashtruan pyetjet, çështja që të jenë dukshëm Strategjia e Sigurisë së Kosovës, sidomos kur ka të bëjë me draftimin apo amandamentimin, e ne një fazë kur të vijë të Komisioni jonë çështja e Strategjisë së Sigurisë së Kosovës, për arsye se Strategjia e Sigurisë së Kosovës së vitit të kaluar fare nuk është parë, nuk është komentuar, shpesh nuk është ditur edhe që ekziston.

Zafir Berisha- Lidhur me ngritjen a kapaciteteve për të cilat foli edhe Gjenerali, cilat janë kriteret e gradimit, u fol për një numër 150 të rinj, a janë të gjithë meritore apo jeni nën ndikimin e kuotave të caktuara që e caktojnë rregulloret dhe ligjet, edhe të kuotës gjinore po edhe të kuotës se minoriteteve? A është mundësia që investimet kapitale të janë të barabarta në të gjitha periudhat kohore që të mos koncentrohen investimet kapitale kryesisht në tre muajt e fundit të vitit?

Ganimete Musliu- Lidhur me raportin vjetor të Ministrisë së FSK-së, shihet këtu të drejtat e njeriut dhe barazia gjinore, flitet me mburrje për barazi gjinore, ndërsa e shihet vetëm një tabelë dhe kur kemi të bëjmë me barazi gjinore të paktën ndoshta do të kishte qenë mirë të kemi tabela

krahasuese herën tjetër që të dimë se ku jemi, se këtu është vetëm një tabelë ku paraqitet gjendja e gradave të gjinisë femërore në FSK dhe fatkeqësisht kemi vetëm deri në gradën kolonel, ky ka qenë shqetësimi edhe ne mandatin e kaluar që e kam ngritur disa herë dhe do të jetë prioritet edhe këtë mandat deri sa ta shoh një femër gjeneral, sepse gjithmonë kërkesën time të drejtë besoj e bazoj në potencialin që e ka FSK-ja, konkretisht gjinia femërore.

Në agjendën time kam pasur në plan t' i vizitoj edhe ushtarët e FSK-së, por të takoj edhe anëtarë ose pjesëtarë të policisë, por nuk kam dashur t' i takoj para se t' i mbajmë këto takime formale me juve, z. mister dhe z. Komandant që thjesht kërkesat e mija të jenë direkte dhe të qarta që vinë direkt nga unë si pjesë e këtij Komisioni dhe gjithashtu shpresoj që do të kemi një bashkëpunim të mirë në këtë mandat.

Qerim Bajrami- Prezantoi që është pjesë e grupit 6+, gjithashtu theksoi se komunitetet që i përkasin këtij grupi janë për transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura. Tutje theksoi se do të përkrah procesin e transformimit duke i mbështet ligjet që vijën për këtë qëllim. Ndërsa sa i përket raportit theksoi se nuk ka vërejtje, por theksoi se në strukturat udhëheqëse të FSK-së duhet të përfshihen edhe përfaqësuesit nga komuniteti boshnjak.

Tutje parashtroi disa pyetje: Pasi projektligji për transformimin e FSK-së është në fazën finale, a do të përfshihet në këtë projektligj edhe përfshirja e komuniteteve.

Si janë marrëdhëniet e ushtarëve mes komunitetit shumicë dhe komunitetit jo shumicë? A organizohen kurse në gjuhën shqipe që komunikimi të jetë më i lehtë mes pjesëtarëve të komuniteteve të tjera?

Ministri i FSK-së, Haki Demolli- Lidhur me pyetjen që parashtroi z. Qerimi, nëse është mirë që të futet neni në ligj sipas të cilit do ju garantohet pakicave një përqindje përkatëse, theksoi se ligji gjithmonë duhet të jete në pajtim me Kushtetutën, kurse Kushtetuta jonë në preambulën e saj duke filluar me fjalën "ne, populli i Kosovës " kërkon që të përkushtuar të krijojmë një shtet të qytetarëve të barabartë, i cili do të garantojë të drejtat e secilit qytetar, vetë kjo fjali në preambulë tregon se shteti Republika e Kosovës iu garanton të drejta të gjithë pjesëtareve të saj të të gjitha komuniteteve të cilat jetojnë në Kosovë.

Po ashtu edhe kapitulli i tretë i parasheh të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtareve të saj, por edhe nga praktika të cilën tani për tani e kemi në Ministrinë e FSK-së, aktualisht 9% e pjesëtarëve të FSK- së janë nga radhët e minoriteteve, kështu që mendoj se duke u bazuar në aktet më të larta normative nuk kemi nevojë që të kemi një dispozite të tillë.

Kurse sa i përket pyetjes së dytë, që ishte pyetja e sensibilizimit të të rinjve, theksoj që Ministria e FSK-së në përgjithësi ka sensibilizuar të rinjtë, me fjalën sensibilizim do të thotë informimin e tyre për aktivitetet e FSK-së për punën, për veprimtarinë e saj, e kjo më së mirë tregon me faktin se në konkurset të cilin kemi me pasur, i cili është në përfundim e sipër të përzgjedhjes së kandidateve, kanë aplikuar 5 mijë e 600 aplikues, prej tyre në procedura janë paraqitur të testimit qoftë atij psikik, fizik apo intelektual, janë paraqitur mbi 4 mijë e 600 për gjithsej 150 vende kadetë të cilën janë pranuar përfundimisht, prandaj kjo tregon se sensibilizimi ka qenë në nivel të kënaqshëm.

Për sa i përket çështjes së West Point- it, duke ju falënderuar SHBA kemi pasur një konkurs sipas të cilit duhet të dërgohen kandidatet më të mirë për trajnim dhe shkollim jashtë vendit,

konkretisht në SHBA, fillimisht ka qene vetëm brenda strukturës por më vonë është zgjeruar edhe jashtë strukturës, sepse qëllimi ynë ka qenë që të dërgojmë dike nga Kosova i cili do të shkollohet dhe trajnohet në SHBA në mënyrë që ai pastaj të kthehet si kuadër i FSK-së, sa i përket sensibilizimit ka qenë e publikuar në ueb-faqen e ministrisë. Gjithashtu janë informuar përmes mediave elektronike, ashtu edhe ato të shkruara dhe numri i atyre që janë paraqitur ka qenë mjaft i madh, por që nuk kanë mundur t'i plotësojnë kriteret është diçka tjetër, sepse nuk janë varur kriteret nga Ministria e FSK –së drejtpërdrejt, por janë varur nga donatorët në rastin konkret nga SHBA- ja.

Çështja e tretë është sa i përket të drejtave të njeriut respektivisht avancimit të pjesëtarëve oficerë të gjinisë femërore në FSK, pyetjes shtruar nga znj. Mulsiu, tha se i dëshiron mirëseardhje në Ministrinë e FSK-së kurdo qoftë, ne jemi të hapur dhe mendoj që dakordohemi me ju që është mirë që të kemi një avancim të një femre në gradën e gjeneralit, por aktualisht unë e kam gjetur në këtë gjendje, vetëm sa për media të them se FSK-ja respekton edhe faktorin gjinor dhe në radhët e veta ka tani për tani diku 8% të pjesëtarëve të gjinisë femërore që krahasuar edhe me vendet në rajon, por edhe me vendet që janë shumë ma demokratike se në, në qëndrojmë shumë më mirë në këtë aspekt!

Gjeneral Kadri Kastrati- Në përgjigjeje të pyetjes së z. Quni tha se, faktori njeri gjithmonë ka qenë një prej çështjeve kyçe në forcën e sigurisë dhe ashtu e kemi trajtuar gjithmonë, duke pasur parasysh që zhvillimin, që nga pranimit i pjesëtarëve të rinj me kriterë që ne nuk lëshojmë as njëherë nivelin e kriterëve, që janë të përafërta me shtetet perëndimore apo me NATO-në, deri te avancimet për lëvizje në pozita horizontale, vertikale sipas nevojës të brendshme të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe në çdo here i është dhënë rëndësi faktorit njeri.

Natyra e forcave të armatosura në përgjithësi e kërkon që marrëdhëniet ndër njerëzore apo puna ekipore duhet të jetë shumë e nivelit të lartë edhe unë e çmoj, ne si pjesëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës marrëdhëniet ndër njerëzore i kemi në nivelin ma të lartë të mundshëm, sa i përket komandës dhe kontrollit, siç i quajmë ne apo marrëdhënieve vertikale asnjë here nuk ka hasur në probleme të tilla, për arsye ne e kemi rregulloren edhe kodin disiplinor dhe gjitha urdhrat shkojnë nga lart - poshtë dhe gjitha raportet nga poshtë lart vinë deri tek unë, për këtë arsye Forca e Sigurisë së Kosovës punon, vepron me kapacitetet e veta dhe asnjë herë nuk kemi ngecje në këtë drejtim. Unë si komandant i kësaj force çdoherë e kam vlerësuar nivelin më të lartë të komandës dhe kontrollit brenda për brenda Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Për zhvillimin në karrierë ne e kemi procedurën dhe rregulloret që janë në fuqi dhe njëherë në vit bëhen avancimet, në Forcën e Sigurisë së Kosovës avancimet bëhen në bazë të rezultateve, kemi disa kriterë që i përcakton për avancimin e oficerëve dhe nënoficerëve dhe në këtë drejtim unë ju kisha përgjigjur se këtu ndikon vlerësimi vjetor i pjesëtarit, ndikon shkollimi dhe trajnimi i tij, ndikon gjithashtu edhe performanca e një oficerit gjatë punës, karrierës që e ka kryer në vendin ku ka qenë.

Ne gjithmonë jemi munduar dhe mundohemi dhe synim i yni ka qenë që çdo avancim në gradë, apo çdo lëvizje horizontale të jetë në standarde që ne i kemi përqafuar dhe asnjëherë nuk kemi pas ndonjë ankesë apo ndonjë shkelje të këtyre standardeve, mendoj shume fuqishëm ne jemi në rrugë të mirë për t'i realizuar edhe qoftë të drejtat individuale të oficerëve apo të drejta e njeriut.

Motivimi i pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë sigurisht që është paga mirëpo, një prej arsyeve është për të shërbyer në vendin e vet, për të kryer detyrat fisnike, detyrat patriotike, detyrat që

janë shumë të rëndësishme në shërbim të qytetarëve të Republikës së Kosovës, që e keni edhe në raport. Ne përveç punëve të përditshme kryejmë edhe shumë detyra në përkrahje të komuniteteve, si trajnime apo vetëdijësim nga minat, përgjithësi ne punojmë shumë për të qenë afër qytetarëve, në mesin e qytetarëve dhe kjo neve na mburrë gjithmonë, krahas zhvillimit operacional, krahas aktiviteteve synojmë që të jemi afër qytetarit që tija lehtësojmë kushtet e jetesës.

Ndërsa në përgjigje të pyetjeve dhe sugjerimeve të z. Rexhep Selimi tha se gjithmonë i mirëpresin këshillat, për arsye se ju na keni ndihmuar me vite që Forca e Sigurisë nëpër mes këshillave dhe me ndihmën e juaj ne jemi këtu ku jemi si institucion jashtëzakonisht i respektuar dhe i zhvilluar në aspektin profesional dhe ne do ta kemi parasysh që në të ardhmen raportet t'i ndryshojmë formën. Mirëpo raporti im, si Komandant, bazohet në objektivat e ministrit dhe unë gjithmonë do të fokusohem që objektivat e ministrit të shkojnë të zhvillohem deri në fund dhe në këtë drejtim kemi punuar, mirëpo do ta kemi parasysh që në të ardhmen ta ndryshojmë formën e raportimit për juve, si Komision, për mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Ne kemi përfunduar doktrinën kryesore të Forcave të Armatosur, grupi punues nga ekspert brenda Forcave të Sigurisë së Kosovës që ne e kemi formuar, kanë punuar në mënyrë shumë profesionale, në mbështetje të ekspertëve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ku dy herë e kanë vizituar Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe kanë punuar bashkë me ekipin tonë dhe gjithashtu komunikimi në distancë që ne e bëjmë me këta dy ekspertë, kemi arritur në draftimin kryesor të doktrinës së përgjithshme dhe javën e kaluar kemi formuar grupet punuese për përpilimin dhe fillimin e draftimit të doktrinave të tjera të nevojshme për Forcat e Armatosura, duke filluar nga doktrina e personelit deri te doktrinat e tjera për çdo fushë veç e veç edhe e kemi një plan dinamik të zhvillimit të këtyre doktrinave.

Struktura e Forcave të Armatosura ka pësuar ndryshime, ka ndryshime duke marrë për bazë Forcën e Sigurisë, ka ndryshime edhe në numër, ka ndryshime nga misioni, pajisjet, transporti, armatimi dhe gjitha pajisjet e tjera që normal duke pasur për bazë ngritjen e kapaciteteve mbrojtëse të Republikës së Kosovës. Ne bashkë me DIR-in, kryeministrin dhe ekspertët nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës kemi marrë për bazë që nga vlerësimi i rreziqeve e deri te kostoja, dhe kemi ardhur në përfundim që ajo strukturë është e draftuar dhe e rekomanduar. Mendoj që i përmbush të gjitha nevojat e Republikës së Kosovës për t'i përmbushur detyrat që dalin nga misioni i ardhshëm që do të jetë i miratuar.

Ne e kemi paraparë, bazuar në plani 10 vjeçar zhvillimor të Forcave të Armatosura, gjithashtu kemi bërë një studim të thellë se sa dhe çka ne duhet të furnizojmë apo të bëjmë blerjet në të ardhmen për t'i përmbushur të gjitha nevojat që do të dalin nga misioni i ardhshëm dhe nga struktura e ardhshme.

Ministri e ceku se kemi marrë edhe deklaratën e nënshkruar nga Ministria e Financave që Qeveria e Republikës së Kosovës është e gatshme që ta mbështes planin afatgjatë zhvillimor dhe rekomandimet që kanë dalë nga rishikimi strategjik i sektorit të sigurisë, ne asnjëherë nuk e kemi bërë tremujorin e fundit shpenzimet e buxhetit, por jemi bazuar në planin dinamik që e kemi planifikuar dhe ashtu edhe e kemi realizuar.

Sa i përket përdorimit të automjeteve kemi shumë operacione që kryejmë gjatë orarit të punës, kemi operacione që i kryejmë 24 orë, sidomos i kemi dy ekiye të cilat janë në kujdestari në thirrjen e qytetarëve, thirrjen nga Policia e Kosovës për asgjësimin e mjeteve të pashpërthyer që qytetarët hasin nëpër territorin e Republikës së Kosovës, mund t'ju them që minimumi në

mesatare kemi dy intervenime brenda 24 orëve dhe këta pjesëtarë lëvizin me mjete taktike nëpër terren, gjithashtu kemi edhe shume operacione të tjera që Forca e Sigurisë së Kosovës duhet t'i përmbush bazuar në planin e vet dhe bazuar në misionin që e ka, gjithashtu unë ju garantoj që një prej arsyeve të lëvizjes me automjete është mbajtja e operacionalitetit të Forcës së Sigurisë ta mbajmë gjithmonë dhe duhet të jemi të gatshëm që t'i kryejmë të gjitha detyrat por ne, unë personalisht, si Komandat, i kam dhënë urdhër që nëpërmes zinxhirit komandues që këtë duhet respektuar. Sa i përket invaliditetin të pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës ne e kemi çdo vit testimin fizik dhe kemi testimin mjekësor të pjesëtarëve të FSK-së, çdo pjesëtar i cili nuk i përmbush këto kritere, qoftë testimi fizik apo testimi mjekësor janë rregulloret, janë procedurat, ne veprojmë sipas tyre, por unë ju garantoj që çdo pjesëtar deri më tani i plotëson gjitha këto standarde, a e ka invaliditetin e duhur apo nuk e ka aty është çështje tjetër aty paraqiten me letra, ata i plotësojnë kriteret dhe procedurat standarde për të qenë pjesëtarë të FSK-së. Unë garantoj për arsyeje i kemi edhe testet, nëse kemi dëshirë mund të keni qasje.

Gjenerali- Kadri Kastrati- Sa i përket marrëdhënieve ndëretnike brenda FSK-së apo marrëdhënieve të komuniteteve joshqiptar me shqiptarët brenda FSK-së, është e mirë mund të them jashtëzakonisht e mirë, asnjëherë deri më tani nuk ka pasur asnjë ankesë nga komunitetet joshqiptare se ata ndihen keq apo trajtohen në mënyrë jo të barabartë.

Janë organizuar kurse të gjuhës shqipe për gjithë pjesëtarët të cilët nuk e flasin gjuhë shqipe dhe ata e kanë mirëpritur jashtëzakonisht mirë këtë iniciativë, i kanë përfunduar me sukses dhe tash komunikimin në mes vete e kanë shumë më të lehtë, si ka qenë më përpara, mirëpo në vazhdimësi ne edhe në të ardhmen synojmë të organizojmë kurse të tilla sidomos për pjesëtarët e rinj që do të jenë pjesë e FSK-së.

Sa i përket pyetjeve të z. Ibishi, ministri Demolli ju përgjigj që kemi sensibilizuar shoqërinë dhe brenda për brenda FSK-së, kërkojnë standarde jashtëzakonisht të larta për West Point, ne synojmë dhe kemi bërë një hap përpara, prej para një muaji unë kam dhënë një urdhër që të fillojnë përgatitjet për vitin e ardhshëm dhe ne synojmë që vitin e ardhshëm ta kemi së paku një kandidat, që për neve do të ishte jashtëzakonisht mirë, ta kemi në këtë akademi prestigjioze ushtarake, e cila është shumë e respektuar.

Kurse sa i përket ngritje së kapaciteteve të përbashkëta, në kuadër të konceptit të NATO-së mbrojtja e mençur, ne kemi punuar jemi në kontakt me homologët në rajon, në çdo konferencë ngritet si çështje, ngritja e kapaciteteve të përbashkëta jo vetëm në fushën e edukimeve, por edhe në fushën e ngritjes së kapaciteteve operacionale dhe ne në këtë drejtim kemi bërë një hap jashtëzakonisht të madh, dhe jemi në ngrije e sipër të kapaciteteve të kërkim shpëtimit rajonal, ku këto kapacitete synojmë që vitin e ardhshëm deri në tetor që të janë të certifikuar prej faktorit ndërkombëtar, të janë të gatshme jo vetëm në aspektin nacional, por edhe në aspektin rajonal që t'i vijmë në ndihmë katastrofave.

Reformat brenda FSK-së në çdo vjet synojmë që të bëjmë reforma në drejtimin pozitiv, qoftë ajo në ngritje të performancës së pjesëtarëve, qoftë në shkollim, trajnim, në infrastrukturë, modernizim, pajisje dhe çështje tjera dhe ne çdo herë e kemi synim jo vetëm mbajtjen e kapaciteteve ekzistuese, por e kemi synim që t'i ngritim këto kapacitete dhe forca e sigurisë me kapacitetet e saja në gjitha fushat të jetë e gatshme për të reaguar nëse kërkohet nga institucionet qendrore dhe nëse kërkohet edhe në aspektin regional.

Gjenerali Kadri Kastrati- Sa i përket kritereve të gradimit që e bëri z. Berisha, ne e kemi procedurën standarde dhe nuk lëshojmë pe në këtë drejtim, secili pjesëtar për t'u graduar duhet të plotësojë disa kritere, qoftë vlerësime vjetor që ne i kemi, për oficer nënoficer, shkollimi, trajnimi, performanca e tij/saj gjatë tri viteve dhe gjitha këto ne i bëjmë me një kujdes jashtëzakonisht për të mos lënë ndonjë oficer i cili përmbush kriteret.

Pastaj tha se garanton që nuk ka nepotizëm, nuk ka standarde të dyfishta brenda Forcës së Sigurisë. Rekrutimi bëhet në bazë të kritereve, nuk kemi standarde të dyfishta as për komunitetet joshqiptare, secili pjesëtar që dëshiron të jetë pjesë e Forcës së Sigurisë, pjesë e uniformës duhet të plotësojë disa kritere që i ceku z. Demolli, prej testit të inteligjencës, testit fizik, testit mjekësor dhe testeve të tjera, duhet të plotësojë të gjitha kritereve për të qenë pjesë e FSK-së.

Investimet kapitale ne i bëjmë kërkesat, por sekretari do t'ju flet më shumë, mirëpo ne çdo vit paraprak kemi planifikime vjetore, kemi planifikime afatmesme, mirëpo kemi planifikime afat gjata dhe ne nuk investojmë asnjë euro pa pasur nevojë.

Sa i përket pyetjes së fundit për barazi gjinore, që FSK-ja një prej sukseseve të veta, që mundet me u krenuar edhe investimi për barazi gjinore, investimi jonë ka qenë jashtëzakonisht të lartë, ne jemi krenar për prezantimin dhe përfaqësimin e tyre, ne e kemi pasur një përfaqësuese në Akademinë Mbretërore në Britaninë e Madhe, e cila prej 800 studentëve ka qenë e treta, kemi investuar në aspektin e trajnimit, por pse nuk kemi gjenerale është se ne kemi standarde, nuk gradojmë me dëshira, nuk gradojmë në bazë të gjinisë, por gradojmë me merita.

Ne do të dëshironim shumë që të kemi një femër gjenerale dhe do të punojmë shumë në këtë drejtim për t'i shtyre në fushën e edukimit dhe trajnimit, unë ju them lirisht që dërgimi i pjesëtarëve të FSK-së në trajnim jashtë vendit, femra e prezantuar, kolonel Spahiu tash e fundit në një trajnim në Shqipëri.

Ganimete Musliu- Gradimi i pjesëtarëve të FSK-së treguat që bëhet në bazë të trajnimeve, shkollimit dhe ju treguat që nuk ka pasur pakënaqësi për gradime. Pyetja ime është a do të thotë që femra në FSK nuk kanë treguar performancën e jashtëzakonshme për të pasur gradën e gjenerali?

Gjenerali Kadri Kastrati- Theksoi se nga raportimi i fundit nuk janë bërë gradime, që nuk do të thotë që në të ardhmen nuk do të jetë gjeneralja e parë femër, nuk e përcaktojmë ne, por që nga raportimi i fundit nuk kemi pasur gradime dhe për këtë arsyeje nuk e kemi një femër gjenerale.

Kryetari- Bëri vërejtje lidhur për raportin e shpenzimeve financiare, i cili nuk është as për së afërmi ai raport i cili do duhet t'ju paraqitet deputetëve.

Sekretari- Fillimisht duhet t'ju informoj në lidhje me raportin e vitit 2014 i cili veç është para jush, ky raport është hartuar para përfundimit të vitit fiskal dhe duhet t'ju informoj që nga buxheti i planifikuar për Ministrinë e FSK-së për 2014, ne kemi shpenzuar 97.7% të buxhetit apo nga totali i buxhetit kemi shpenzuar 39 milionë e 5 mijë, dua t'ju informoj që konform

planit të veprimit të vitit 2014 konform objektivave të ministrit janë implementuar mbi 96 % të aktiviteve të planifikuara për implementimin e objektivave.

Ndërsa para nesh është edhe plani i veprimit për vitin 2015 konform objektivave të ministrit aktual janë hartuar gjitha aktivitetet dhe periodat për implementimin e tyre dhe presim që të bëjmë implementimin e plotë të tyre, për vitin 2015 buxheti i planifikuar dhe i miratuar në Parlament për Ministrinë e FSK-së dhe FSK-në është 45 milionë e 285 mijë euro, ndërsa ne i kemi filluar sipas planit vjetor të prokurimit dhe plani vjetor të rrjedhjes së parasë, aktualitete që përfshihen në këtë plan kemi filluar edhe për procedurat e mëtutjeshme.

Z. Selimi në fakt e potencoj, se a mjafton buxheti aktual për realizimin e misionit që e ka, do të deklaroj me kompetencë se i plotëson nevojat minimale duke mos marrë parasysh mundësinë e fillimit të implementimit të produkteve që kanë dalë nga RSSA dhe të planit afatgjatë zhvillimor, kjo është edhe arsyeja që në draftligjet që i kemi orientuar për Qeverinë e Kosovës e kemi paraparë që viti zero i fillimit të implementimit të buxhetit të jetë viti 2016 dhe në kuadër të saj deklarata financiare që është miratuar, deklaratë mbështetëse nga Ministria e Financave, figuron që buxheti është konform planit zhvillimor dhe do të jetë si në vijim, për vitin 2016 do të filloj 54 milionë euro, që do të thotë 9 milionë euro mbi buxhetin aktual të vitit 2015 dhe 7 milionë euro mbi buxhetin e planifikuar në kornizën afatmesme të shpenzimeve, pastaj sipas viteve shkon 62.4, 67,72 deri në vitin 2025 plani zhvillimor është 2016-2025, arrin në 93.8 milionë euro, ky është buxheti që është miratuar në parim dhe përkrahur me deklaratën financiare të draftligjeve për forcat e armatosura.

Në kuadër të saj ne e kemi edhe planin afatgjatë zhvillimor që e potencuan ministri dhe komandanti i cili në fakt e parashih buxhetin dhe koston e të gjitha pajisjeve të duhura për krijimin e mundësisë së rekrutimit të stafit të ri sipas organogramit të ri, si dhe për pajisjet nga pajisjet individuale deri te pajisjet kolektive, për të gjitha llojet e pajisjeve të tjera speciale përfshirë edhe armatimin, që në kuadër të misionit, strukturës dhe numrit të personelit që do ta ketë forca e ardhshme e sigurisë, me këtë buxhet që është i planifikuar dhe i përkrahur nga Ministria e Financave dhe nga Qeveria ne jemi të bindur që do të mund të plotësojmë nevojat minimale për plotësimin e nevojave të misionit të ri.

Po ashtu desha t'ju informoj që në kuadër të raportimeve të rregullta, në kuadër të ekzaminimeve të rregullta që bëhen dhe mekanizmave të kontrollit të brendshëm, ne në të gjitha raportet financiare dhe raportet e auditimit të përgjithshëm kemi pasur opinion të pakualifikuar në prezantimin e pasqyrave financiare, në fund vitin e kaluar në muajin shtator e kemi përfunduar fazën e parë të auditimit, nga dita e hënë nga 2 deri në 27 mars do të kemi fazën e dytë të auditimit dhe me datën 14 maj e presim raportin final të auditivit. Shpresojmë që edhe në pasqyrat financiare të vitit 2014 Ministria e FSK-së të jetë ministri shembull në raportin që do ta kem në këtë çështje,.

Ndërsa sa i përket pyetjes së z. Berisha, pse përqindja e buxhetit të shpenzuar është më e madhe në tre mujorin e fundit të vitit fiskal, kjo qëndron arsyeja kryesore e kësaj është se shumë nga kontratat që ne gjatë planit të prokurimit dhe planit të buxhetit i nënshkruajmë në fillim ose nga mesi i vitit, koha e referimit të përmbajtjes së kontratës është shumë e gjatë.

Ministri i Ministrisë së FSK-së- Haki Demolli- Falënderoi komisionin për komentet e bëra dhe njëherit theksoi se, për çdo keqpërdorim eventual, për çdo lëshim eventual që mund të ndodhë

ne, si ministri, jemi të hapur, jemi bashkëpunues dhe atë që thashë edhe me parë me qëllim të vetëm që të kemi një ministri dhe një FSK sa më të profesionalizuar.

4. Të ndryshme

Kryetari- I njoftoi për vizitën që do të realizojë Komisioni në Gjermani më 19 maj dhe kërkoi nëse pajtohen edhe anëtarët e Komisionit.

Gjithashtu i njoftoi për një Kompani e telekomunikimeve e cila i sanksionon përgjimet, dhe kjo kompani është e interesuar të bëjë një prezantim në Komision për të parë se si operojnë.

Propozoj që do të ishte mirë t'i kishim në Komision për të parë prezantimin e tyre i cili do të t'i kontribuonte edhe ligjeve që do t'i kemi në shqyrtim.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Daut Haradinaj